




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës Nr.5-400-56392 e datës 13.11.2020, nga Naim Llugiqi nga fshati Magure, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500 € (njëmijë e pesëqind euro), Naim Llugiqi nga fshati Magure, sipas kërkesës së tij Nr.5-400-56392 e datës 13.11.2020, për ta mbështetur financiarisht për relaizimin e një koncerti në qytetin e Lipjanit për nder të festës së "28 Nëntorit" koncerti do të mbahet në bazë të projektit të paraqitur nga organizator në mënyrë që të mos rrezikohet shëndetit i qytetarëve nga COVID-19.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhironlogarinë bankare të paraqitësit të kërkesës, në Nr. 1501080001467538 në Raiffeisen Bank.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell dëshmi për realizimin e projektit deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 31.12.2020.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Naim Llugiq nga fshati Magure.

1Nr. 400-56392
Lipjan, më 20.11.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

